



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.641/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.08.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së datë 29.06.2016, lidhur me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Bean” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me numër REF-39804-05-30-2016, me objekt “*Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja” Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33.”*, me fond limit 55,613,884 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 22.06.2016, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

Ankimues: “Bean” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “Qender” pranë shkollës 8 vjeçare Levan, Fier

Autoriteti Kontraktor: Ujësjellës Kanalizime Tiranë
Rruga 5 Maji, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.05.2016 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. 39804-05-30-2016, me objekt “*Rikonstruksioni I dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja*” Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33.”, me fond limit 55,613,884 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 22.06.2016, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë.

II.2. Në datën 22.06.2016 është zhvilluar procedura e mësipërme e prokurimit.

II.3. Në datën 29.06.2016, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Shendelli	nuk ka paraqitur ofertë	
Senka/L	nuk ka paraqitur ofertë	
Bean	51.188.491,00	I skualifikuar
Kronos Konstruksion	54.557.097,00	I kualifikuar

II.4. Operatori Ekonomik “Bean” sh.p.k është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat se:

Operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k me nr. NIPT-i J72510445Q, me administrator Zj. Eva Sadushi, me ofertë ekonomike me vlerë prej 51,188,491 (pesëdhjetë e një milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH. Për këtë operator ekonomik Autoriteti Kontraktor UKT sh.a. mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 13, pika 3, gërma a me anë të shkresës Nr. 14889 Prot datë 29.06.2016 ka bërë kërkesë për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik nga për arsye se: Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k. për tenderin me objekt "Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja)" Loti II nga piketa "17" deri te piketa "33" mes të tjerash është paraqitur dhe fletë doganimit me Nr. R 24117 datë 26.03.2015, me anë të të cilit janë zhdoganuar makineritë e mëposhtëme: • Trencher me vakum • Trencher per hapje kanali • Pajisje nivelues Për fletë doganimit e mësipërm i është kërkuar informacion Doganës Durrës, në lidhje me makineritë e zhdoganuara me shkresën Nr. 14524 Prot. datë 22.06.2016. Kërkesës së mësipërme i është kthyer përgjigje nga Dogana Durrës me shkresën Nr. 10747/1 Prot. datë 28.06.2016, nga ku rezulton se me fletë doganimit Nr. R 24117 datë 26.03.2015, nuk është zhdoganuar asnjë prej grupeve të mësipërme të makinerive, por ekskavator i përdorur Neë Holland komplet me nivelues 1 copë, V.P-2006. Nga sa më sipër operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k. rezulton se ka paraqitur dokument të falsifikuar për këtë objekt prokurimi.

II.5. Në datën 04.07.2017, operatori ekonomik "Bean" sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në ankesën drejtuar autoritet kontraktor, operatori ekonomik ankimues kundërshton vendimin e KVO-së datë 29.06.2016 në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

Në lidhje me arsyet e skualifikimit ju sqarojmë se të gjitha pajisjet e përmendura nga ju, janë aksesore të ekskavatorit Neë Holland dhe janë zhdoganuar si pjesë përbërëse e tij. Pretendimi juaj nuk qëndron. Do të ishte që paraprakisht të kishit kërkuar sqarime nga ana jonë pasi veprimet e njëanëshme nga ana juaj dhe skualifikimi i padrejtë duket abuziv dhe tendencios.

II.7. Në datën 06.07.2016, me shkresën nr.15091/1 prot, operatori ekonomik ankimues "Bean" sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.8. Në datën 14.07.2016, pala ankimuese "Bean"sh.p.k.,ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 16027/1 prot., datë 22.07.2016, protokolluar me tonën 1646/2, datë 26.07.2016 me objekt "Dërgim informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese “Bean” sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyetimin se “Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “BEAN” sh.p.k. për tenderin me objekt “Rikonstruksioni i dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja)” Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33” mes të tjerash është paraqitur dhe fletë doganimit me Nr. R 24117 datë 26.03.2015, me anë të të cilit janë zhdoganuar makineritë e mëposhtëme: • Trencher me vakum • Trencher per hapje kanali • Pajisje nivelues Për fletë doganimit e mësipërm i është kërkuar informacion Doganës Durrës, në lidhje me makineritë e zhdoganuara me shkresën Nr. 14524 Prot. datë 22.06.2016. Kërkesës së mësipërme i është kthyer përgjigje nga Dogana Durrës me shkresën Nr. 10747/1 Prot. datë 28.06.2016, nga ku rezulton se me fletë doganimit Nr. R 24117 datë 26.03.2015, nuk është zhdoganuar asnjë prej grupeve të mësipërme të makinerive, por ekskavator i përdorur Neë Holland komplet me nivelues 1 copë, V.P-2006. Nga sa më sipër operatori ekonomik “BEAN” sh.p.k. rezulton se ka paraqitur dokument të falsifikuar për këtë objekt prokurimi” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.2. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.3. Në shtojcën 10 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” në pikat 2.3.7, 2.3.8 dhe 2.3.9 të dokumentave të procedurës objekt ankimimi përcaktohet se:

Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin

e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion te cilat jane si me poshte vijon:

<i>Nr</i>	<i>Lloji I makinerive</i>	<i>Pronësia</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Kamiona, kapaciteti total mbajtës minimumi 15 ton</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>minimumi 5</i>
<i>2</i>	<i>Rimorkio për levizjen e mjeteve</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>3</i>	<i>Trencher me vakum</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>4</i>	<i>Motogjeneratorë</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>5</i>	<i>Trencher per hapje kanali jo me i vogel se 2 ton</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>6</i>	<i>Ekskavator me zinxhir me çekic pneumatik</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>7</i>	<i>Prerese asfalti</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>8</i>	<i>Kamionçine deri nr 4.5Ton</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>9</i>	<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>10</i>	<i>Betoniere 0.5 m3</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>
<i>11</i>	<i>Vibrator</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>3</i>
<i>12</i>	<i>Pompë uji</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>13</i>	<i>Vibrator elektrik sipërfaqësor</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>14</i>	<i>Fadrome me goma</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>15</i>	<i>Pajsje niveluese për nivelim shtresash</i>	<i>në pronesi ose me qera</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>

16	Makine per ngjitje tubash PE	në pronesi ose me qera	copë	2
17	Kompaktor per ngjeshje shtresash	në pronesi ose me qera	copë	1
18	Rrul asfalti hekur-hekur (kapaciteti 8 ton)	në pronesi ose me qera	copë	2
19	Kamion me vinç kapaciteti total mbajtës minimumi 15 ton	në pronesi ose me qera	copë	2
20	Rrul asfalti me goma (kapaciteti 8 ton)	në pronesi ose me qera	copë	1
21	Linje prodhim Betoni	në pronesi ose me qera	copë	1

2.3.8 Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces 9 te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

Për paisjet teknike në pronësi duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes ose akt zhdoganimi.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe fotot e mjeteve. Për mjetet me qera, dokumentet e mesiperm të shoqërohen edhe me kontraten përkatëse të qerasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Linjë prodhim betoni në pronësi ose me qera te jete e shoqëruar me: lejen e ndërtimit dhe autorizim mjedisor (leje) për aktivitetin: Impiant prodhim betoni (QKL Kodi:III.1.A) si dhe vërtetim nga OSHEE që ka likuaduar faturat e maturuara të energjisë.

2.3.9 Makinerit e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te kryeje te gjithe verifikimet e nevojshme per te vertetuar deklarimin e mesiperm.

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues “Bean” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Fletë doganimi Nr. 24117, datë 26.03.2016 lëshuar nga Dogana Durrës, në të cilat janë përshkruar mallrat e mëposhtme:
 - Trencher me vakum
 - Trencher për hapje kanali
 - Pajisje nivelues

III.1.5. Nga informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor nr. 16027/1 Prot., datë 22.07.2016 rezulton se ky i fundit ka kërkuar informacion pranë Doganës Durrës me shkresën nr. 14524, datë 22.06.2016 lidhur me përmbajtjen e fletë doganimit nr. 24117, datë 26.03.2015, më konkretisht nëse në dokumentin e sipërcituar janë zhdoganuar makineritë e mëposhme:

- Trencher me vakum
- Trencher për hapje kanali
- Pajisje nivelues

III.1.6. Në datën 28.06.2016 me shkresën nr. 10747/1 Dega e Doganës Durrës i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor si dhe i ka bashkëlidhur draftin e deklaratës doganore IM.4 R-24117 datë 26.03.2015 të nxjerrë nga sistemi elektronik i përpunimit të deklaratave doganore “ASYCUDAWorld”. Nga verifikimi rezulton se me fletë doganimin Nr. 24117, datë 26.03.2015, nuk është zhdoganuar asnjë prej grupeve të mësipërme të makinerive, por eskavator i përdorur Neë Holland komplet me nivelues 1 copë, V.P-2006.

III.1.7. Në datën 29.06.2016 me shkresën Nr. 14889 Prot. autoriteti kontraktor ka dërgur pranë Agjencisë së Prokurimit Publik “Kërkesë për përjashtimin e operatorit “Bean” sh.p.k nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit”. Me arsyetimin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Bean” sh.p.k është i falsifikuar pasi me të njëjtin dokument, që ka të njëjtin numër reference dhe të njëjtën datë, nuk mund të zhdoganohen dy grupe të ndryshme makinerish.

III.2. Komisioni i Prokurimit Publik duke marrë shkas nga indiciet e sipërcituara dhe arsyet e skualifikimit, ka kërkuar informacion pranë Degës së Doganës Durrës, me anë të shkresën Nr. 1770 Prot, datë 29.07.2016, për vënien në dispozicion për të dhënat që disponohen mbi deklaratën doganore Nr. 24117, datë 26.03.2015.

Në përgjigjen e kthyer nga ana e Degës së Doganës Durrës, Nr. 12529/1 Prot., datë 16.08.2016 është dërguar fotokopja e opraktikës doganore nr. 24117, datë 26.03.2015. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar rezulton se me fletë doganimin nr. 24117 është zhdoganuar **“Eskavotor i perd. New Holland komplet me nivelues 1 copë, V.P-2006”**.

III.2.1. Bazuar në verifikimin e bërë pranë Degës së Doganës Durrës dhe dokumentacion shoqërues të përgjigjes së këtij institucioni, Komisioni i Prokurimit Publik në kushtet kur evidenton indicie dhe dyshime mbi saktësinë dhe vërtetësinë në përmbajtje të fletë doganimit të cituar mësipër, gjykon se operatori ekonomik “Bean” sh.p.k nuk përmbush kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike, në mënyrë specifike për (i) Trencher me vakum, (ii) Trencher për hapje kanali, (iii) Pajisje nivelues.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Bean” sh.p.k nuk qëndron.

Në vijim, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se shqyrtimi i çështjeve të mësipërme në lidhje me të dhëna të ndryshuara në dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë, është përtej kompetencës lëndore të këtij të fundit. Referuar nenit 19/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku parashikohet se *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”*. Në këto kushte, referuar materialeve të administruara në

fashikullin e gjykimit, Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 13 të *lex specialis* i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bean” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me numër REF-39804-05-30-2016, me objekt “Rikonstruksioni I dy linjave të qendrës (Nga rruga Todi Shkurti deri te Pedonalja” Loti II nga piketa “17” deri te piketa “33.”, me fond limit 55,613,884 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 22.06.2016, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit në lidhje me konstatimet e mësipërme.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1646 Protokoli; Datë 14.07.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri